Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/609
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafet 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 05/ L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Korrigjohet vendimi Nr. 01/506 i datës 05.08.2022, me të cilin është Ri-akredituar institucioni QPAP OXFORD STUDIO", me adresë: Prishtinë me katër (4) qendra, Prizren me dy (2) qendra, Gjilan me dy (2) qendra, Klinë me një (1) qendër, Gurakoc me një (1) qendër dhe Istog me një (1) qendër, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 31.01.2022 deri më 30.01.2025, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

2. Korrigjimi i vendimit Nr. 01/506 i datës 05.08.2022, bëhet tek pika 1 e Vendimit sa i përket periudhës së Ri-akreditimit dhe i njëjti formulohet/korrigjohet si në vijim:

2.1. Ri-akreditohet institucioni QPAP " OXFORD STUDIO" me adresë: Prishtinë me katër (4) qendra, Prizren me dy (2) qendra, Gjilan me dy (2) qendra, Klinë me një (1) qendër, Gurakoc me një (1) qendër dhe Istog me një (1) qendër, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 31.01.2022 deri më 30.01.2027, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

3. Pjesa tjetër e vendimit 01/506 të datës 05.08.2022 mbetet e pandryshuar.

4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni QPAP " OXFORD STUDIO" me datë 26.05.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë e cila ka marrë numër protokolli 01/289 me të cilën ka kërkuar korrigjimin e vendimit Nr.01/506 të datës 05.08.2022 me të cilin vendim institucioni QPAP "OXFORD STUDIO" ishte Ri-akreditуar për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimin: Kurse të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C2 për periudhë tre (3) vjeçare.

Të njëjtit kërkesën e kanë parashtruar pasi që AKK kishte realizuar vizitë tek institucioni në fjalë për qendrat Fushë Kosovë dhe Mitrovicë me datat 4 dhe 5 maj 2023, dhe nga Ekspertet kishin kuptuar se periudha e ri-akreditimit kishte qenë për pesë vite, e jo 3 vite ashtu siç ishte përcaktuar në vendimin për të cilin kërkohet korrigjimi.

AKK ka proceduar këtë kërkesën për shqyrtim në mbledhjen e KD të AKK-së të mbajtur me datë 05.10.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së pas shqyrtimit të kërkesës Nr. 01/289 e datës 26.05.2023 të institucionit QPAP "OXFORD STUDIO", bazuar në raportet e ekspertëve mbi bazën dhe rekomandimet e të cilave KD kishte marr vendim si dhe sqarimeve shtesë nga ana e zyrtarëve kompetent të AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi i dërgohet:

- QPAP " Oxford Studio" Prishtinë
- Arkivit të AKK- së

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar i KD të AKK-së